



**PASQYRA E PRAKTIKAVE TË MIRA:  
Përdorimi i teknologjisë  
ndihmëse në arsimin e rregullt  
në Maqedoni dhe Austri**



Shkup, may 2015



Projekt për e-akses në  
arsim



**PASQYRA E PRAKTIKAVE TË MIRA:  
Përdorimi i teknologjisë ndihmëse në arsimin e rregullt në  
Maqedoni dhe Austri**

Shkup, maj 2015

Përgatitja dhe publikimi i këtij publikimi janë financuar nga populli amerikan, nëpërmjet Agjencisë amerikane të zhvillimit ndërkombëtar – USAID, e cila është pjesë e misionit të SHBA-ve në Maqedoni. Aktivitetet zbatohen me Projektin e-akses në arsim, i cili zbatohet nga ana e shoqatës Hapni dritaret.

**Qëndrimet e këtij publikimi nuk i shprehin qëndrimet e Agjencisë amerikane të zhvillimit ndërkombëtar ose ato të Qeverisë së SHBA-ve.**

## PËRMBAJTJA

<b>MIRËNJOHJE .....</b>	<b>4</b>
<b>PARATHËNIE .....</b>	<b>4</b>
<b>PROJEKTI PËR E-AKSES NË ARSIM: Implementimi i teknologjisë ndihmëse në arsimin e rregullt në Maqedoni .....</b>	<b>5</b>
Hapi 1: Vlerësimi i nevojave.....	5
Hapi 2: Sigurimi i pajisjeve .....	5
Hapi 3: Trajnimet.....	5
Hapi 4: Materialet dhe resurset .....	5
Hapi 5: Asistenca për implementimin e teknologjisë ndihmëse .....	6
Hapi 6: Informatat dhe shkëmbimi .....	6
Hapi 7: Vlerësimi .....	6
<b>NJË PJESE E RAPORTIT TË HULUMTIMIT: Përdorimi i teknologjisë ndihmëse në 31 shkolla fillore të rregullta .....</b>	<b>7</b>
Hyrje.....	7
Konstatimet .....	7
Konkluzionet.....	11
Rekomandimet.....	11
<b>PËRZGJEDHJE TË PRAKTIKAVE TË MIRA NGA MAQEDONIA .....</b>	<b>13</b>
Teknologjia ndihmëse dhe bashkëpunimi i mirë – faktorë suksesi .....	13
Teknologjia – një mundësi më shumë.....	13
Teknologjia ndihmëse një mjet komunikimi.....	14
<b>PËRZGJEDHJA E PRAKTIKAVE TË MIRA NGA AUSTRIA.....</b>	<b>15</b>
Softuer për akses në arsim .....	15
Shembulli më i mirë: Maks Buheger .....	16
Financimi i teknologjisë ndihmëse në Korushkë .....	18
<b>TEKNOLOGJIA NDIHMËSE DHE DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE .....</b>	<b>19</b>
Konventa e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara .....	19
Agjenda digjitale e Strategjisë Evropë 2020 e BE-së.....	19

## MIRËNJOHJE

**Shoqata Hapni dritaret falënderon të gjithë individët, institucionet dhe organizatat me të cila patëm kënaqësinë të bashkëpunojmë.**

## PARATHËNIE

Pasqyra e praktikave të mira ofron një pjesë të arritjeve dhe përvojave pozitive lidhur me përdorimin e teknologjisë ndihmëse nga ana e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt në Maqedoni. Ky publikim përmban të dhëna statistikore dhe konstatime që konfirmojnë mundësitë më të mira të arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Me raste individuale lexuesve u ofrohet mundësia të fitojnë një pamje të qartë lidhur me përparimin dhe zhvillimin individual të nxënësve.

Drejtimit e aktiviteteve të ardhshme janë paraqitur me disa shembuj të një austriake: leksionet austriake mund të ndihmojnë për të arritur rezultate më të mira në Maqedoni.

Kjo pasqyrë hedh dritë mbi dispozitat e teknologjisë ndihmëse të Konventës së KB mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe Agjendës digjitale të bashkimit Evropian.

## **PROJEKTI PËR E-AKSES NË ARSIM: Implementimi i teknologjisë ndihmëse në arsimin e rregullt në Maqedoni**

Shoqata hapni dritaret në vitin 2010 ngriti iniciativën e implementimit të teknologjisë ndihmëse në arsimin e rregullt fillor në Maqedoni, me mbështetjen financiare të USAID. Projekti për e-akses në arsim kishte për qëllim mbështetjen e përfshirjes dhe lehtësimin e pjesëmarrjes aktive të nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt me ndihmën e përdorimit të teknologjisë ndihmëse gjatë procesit mësimor.

### **Hapi 1: Vlerësimi i nevojave**

Në vitin 2010 u analizuan nevojat e shkollave fillore të rregullta, në aspektin e teknologjisë ndihmëse, me ndihmën e anketave dhe vizitave të realizuara në terren. Raportin përkatës mund ta gjeni [këtu](#).

Në fillim të vitit 2014 shoqata Hapni dritaret zhvilloi një hulumtim të ngjashëm në shkollat e mesme të rregullta. Raportin përkatës mund ta gjeni [këtu](#).

### **Hapi 2: Sigurimi i pajisjeve**

Mbi 30 shkolla fillore dhe dy shkolla të mesme u kompletuan me pajisjet ndihmëse në vazhdim: tastiera me butona të mëdhenj, trakbol, xhojstik, klikime të veçuara kopjo dhe monitorë me prekje/taç. Këtë pajisje plotësojnë nevojat e pjesës më të madhe të nxënësve me aftësi të kufizuara, të cilët ballafaqohen me probleme gjatë përdorimit të pajisjeve kompjuterike standarde ose nuk mund t'i përdorin të njëjtat. Numri i pajisjeve që iu dhuruan shkollave u caktua në përputhje të nevojave të secilës prej tyre.

### **Hapi 3: Trajnimet**

Shoqata Hapni dritaret siguroi trajnime për më shumë se 1.200 mësues dhe anëtarë të shërbimeve shkollore profesionale, por edhe për prindërit, përfaqësuesit e institucioneve arsimore, kominave, organizatave civile, etj. Trajnimet u organizuan lidhur me përdorimin e teknologjisë ndihmëse gjatë punës me nxënësit me aftësi të kufizuara.

### **Hapi 4: Materialet dhe resurset**

Tre aplikacione për akses në arsim u mundësuan në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe dhe u vunë në dispozicion për nevojat e të gjitha shkollave.

Për nevojat e të gjitha shkollave u zhvilluan dhe u vunë në dispozicion dy aplikacione të reja arsimore: njëra për të mësuar shkrim-lexim, ndërsa tjetra për të fituar aftësitë matematikore elementare.

Për nevojat e arsimit fillor u përgatitën 20 libra në formë elektronike, të cilat mund të përdoren me lehtësi nga nxënësit me aftësi të kufizuara.

Për nevojat e mësuesve u përgatitën dhe shpërndanë disa doracakë.

Njëkohësisht shkollave dhe opinionit iu ofruan informata të ndryshme, lojëra kompjuterike të lehta, prezantime, etj.

## Hapi 5: Asistenca për implementimin e teknologjisë ndihmëse

Shkollat fituan mbështetje dhe këshilla lidhur me implementimin e teknologjisë ndihmëse. Për këtë qëllim mësuesit vinin në ambientet e Shoqatës Hapni dritaret dhe njiheshin me mënyrën e përdorimit të teknologjisë ndihmëse gjatë punës me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu u organizuan konkurse me vizatime, video dhe krijime letrare të përgatitua me kompjuter, me qëllim që mësuesit dhe nxënësit të motivohen dhe të përdorin teknologjinë ndihmëse. Në këto konkurse u paraqitën qindra nxënës me dhe pa aftësi të kufizuara. Në kuadër të konkurseve mësuesit dërgonin praktika mësimore inkluzive me përdorimin e teknologjisë ndihmëse.

## Hapi 6: Informatat dhe shkëmbimi

U siguruan mekanizma shkëmbimi, që kishin për qëllim të mundësojnë mësimin midis shkollave. U organizuan tryeza të rrumbullakëta rajonale për prezantimin e arritjeve dhe për shkëmbimin e praktikave më të mira dhe leksioneve të mësuara. Me ndihmën e konferencave dhe debateve publike në nivel nacional u shkëmbyen arritjet me një rreth të gjerë ekspertësh, profesionistësh dhe me opinionin.

Në Facebook u hap një grup i veçantë për e-aksesin në arsim dhe ky grup tërhoqi vëmendjen e mbi 2.300 mësuesve, punonjësve të shkollave dhe prindërve.

Në vitin 2013 përfaqësues të institucioneve relevante arsimore dhe organizatave civile morën pjesë në një vizitë studimore në SHBA, e cila iu përkushtua arsimin inkluziv dhe implementimit të teknologjisë ndihmëse gjatë procesit mësimor.

## Hapi 7: Vlerësimi

Në vitin 2012 u zhvillua vlerësimi i parë me përfshirjen e 21 shkollave fillore që përdornin dhe zbatonin teknologjinë ndihmëse. Raportin përkatës mund ta gjeni [këtu](#).

Në vitin 2015 u zhvillua vlerësimi i dytë me përfshirjen e gjithsej 31 shkollave fillore dhe dy shkollave të mesme. Raportin përkatës mund ta gjeni [këtu](#).

Të dy hulumtimet përkatëse vërtetuan se teknologjia ndihmëse përmirëson mundësitë arsimore të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe forcon vetëbesimin e tyre.

## NJË PJESË E RAPORTIT TË HULUMTIMIT: Përdorimi i teknologjisë ndihmëse në 31 shkolla fillore të rregullta

### Hyrje

Objekt i këtij hulumtimi ishin përvojat e 31 shkollave fillore të rregullta në Maqedoni, që përdornin teknologjinë ndihmëse për nevojat e procesit mësimor, në kuadër të Projektit për e-akses në arsim, që u zhvillua gjatë periudhës së viteve 2010-2015.

### Metodologjia

Në fokusin e hulumtimit u gjetën tre çështjet në vazhdim:

- **përdorimi** i pajisjeve dhe materialeve të siguruara në formë donacioni dhe përdorimi i njohurive dhe aftësive të personelit të shkollave, të fituara me ndihmën e trajnimeve;
- **rëndësia** e pajisjeve dhe materialeve të siguruara në formë donacioni dhe trajnimeve të zhvilluara, në raport me nevojat;
- **cilësia** e mbështetjes e shprehur nëpërmjet kënaqësisë së palëve për të cilat jepet kjo mbështetje dhe ajo e efekteve pozitive eventuale (ndikimi).

Anketa përfshiu katër kategori të personave të anketuar:


- shkollat fillore;
- mësuesit;
- nxënësit me aftësi të kufizuara;
- prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Hulumtimi i zhvillua gjatë muajve shkurt dhe mars 2015.


I gjithë raporti mund të gjendet në [ueb-faqen e Shoqatës Hapni dritaret](#).

### Konstatimet


Gjithsej 333 nxënës përdorin një ose më shumë pajisje ndihmëse të fituara në formë donacioni ose softuerët e këtij lloji (opsionet e aksesit), me strukturën më poshtë:








Nxënësit zakonisht përdorin pajisjet në vazhdim:




Nxënësit zakonisht përdorin softuerët në vazhdim:




29 (93,5%) shkollat gjatë punës me nxënësit me aftësi të kufizuara përdorin softuerin edukativ në vazhdim: G-Compris, About numbers dhe Show me.

Një numër i madh mësuesish kanë shprehur kënaqësinë e tyre lidhur me zbatimin e njohurive të fituara me trajnimet, në aspektin e përdorimit të teknologjisë ndihmëse gjatë procesit mësimor:




30 shkolla (96,8%) dhe 130 mësues (97,1%) vlerësojnë se pajisjet e fituara në formë donacioni përputhen me nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara, në shkollat e përfshira në projektin konkret.

118 nxënës (92,9%) përdorin kompjuterin më lehtë me ndihmën e teknologjisë ndihmëse:



Shumica e mësuesve që kanë marrë pjesë në trajnimet vlerësojnë se informatat, njohuritë dhe aftësitë e fituara mund t'i përdorin në punën e tyre, ndërsa për 5 (3,9%) mësues informatat, njohuritë dhe aftësitë

e fituara janë një bazë e favorshme që duhet plotësuar me njohuri të tjera:



26 shkolla (83,9%) kanë vlerësuar se „nuk janë konstatuar defekte ose funksionim joadekuat me pajisjet ndihmëse të fituara në formë donacioni“, ndërsa 5 nga shkollat (16,1%) „shumë rrallë“ kanë konstatuar probleme me pajisjet në fjalë.

125 (93,3%) mësues kanë vlerësuar se përdorimi i doracakëve mbështet dhe lehtëson përfshirjen e teknologjisë ndihmëse në procesin mësimor.

Të 31 shkollat (100%) janë dakord se materialet e shtypura lehtësojnë dhe mbështesin përdorimin e teknologjisë ndihmëse në procesin mësimor.

Trajnimet e zhvilluara dhe mbështetja në formën e konsulencës kanë rezultuar me formimin e ekipeve të teknologjisë ndihmëse në 19 (61,2%) nga gjithsej 31 shkollat. Në 4 (12,9%) shkolla me çështjen në fjalë merret shërbimi profesional, në 5 (16,2%) shkolla me këtë çështje


merret ekipi inkluziv, ndërsa në 3 (9,7%) shkollat e tjera për aktivitetet e këtij lloji angazhohen vetë mësuesit.

30 (96,8%) shkolla vlerësojnë se përdorimi i teknologjisë ndihmëse në procesin mësimor ka rezultuar me ndryshime dhe efekte pozitive tek nxënësit me aftësi të kufizuara.

123 (91,8%) mësues janë të kënaqur me ndryshimet që janë mundësuar tek nxënësit me aftësi të kufizuara me përdorimin e teknologjisë ndihmëse, ndërsa 11 (8,2 %) mësues vlerësojnë se teknologjia ndihmëse nuk ka rezultuar me ndryshime.

Ndryshimet e konstatuara:	Shkollat		Mësuesit	
	Nr.	%	Nr.	%
Rritet interesimi i nxënësve me aftësi të kufizuara për mësimin, por edhe kureshtja dhe dëshira për të fituar njohuri të reja	27	87,1%	91	67,9%
Nxënësve u mundëson të përgatisin më lehtë detyrat e shkollës dhe të mësojnë përmbajtjet mësimore	27	87,1%	83	61,9%
Përmirëson nivelin e përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në procesin mësimor dhe në aktivitetet shkollore	24	77,4%	109	81,3%
Inkurajon ndjenjën e barazisë dhe rrit nivelin e vetëbesimit	23	74,2%	85	63,4%
Në aspektin e përgjithshëm, tek nxënësit me aftësi të kufizuara nuk janë konstatuar ndryshime si rezultat të përdorimit të teknologjisë ndihmëse për nevojat e procesit mësimor	1	3,2%	11	8,2%
<b>Totali i shkollave:</b>	<b>31</b>	<b>/</b>	<b>134</b>	<b>/</b>

Pjesa dërmuese e prindërve vlerësojnë se teknologjia ndihmëse përmirëson nevojat arsimore të fëmijëve të tyre:



Teknologjia ndihmëse pjesës më të madhe të mësuesve (77 nga gjithsej 134 ose 57,5%) u ka mundësuar „të përdorin metoda të reja pune me nxënësit me aftësi të kufizuara“.



## Konkluzionet

Implementimi i teknologjisë ndihmëse në procesin mësimor përmirëson aspektin përfshirës të procesit mësimor dhe rrit mundësitë e përfshirjes aktive të nxënësve me aftësi të kufizuara.

Mesatarisht 10 nxënës përdorin një ose më shumë pajisje ndihmëse ose softuerë të këtij lloji. Këto nxënës ballafaqohen me probleme të ndryshme psiko-fizike.

Përdoren të gjitha llojet e pajisjeve ndihmëse të fituara në formë donacioni. Më së shumti përdoren tastiera me botona të mëdhenj dhe ekrani me taç.

Në të gjitha shkollat zakonisht përdoren softuerët në vazhdim: adaptimi i vendit ose ambientit të punës dhe opsionet e aksesit për miun dhe tastierën.

Softueri edukativ mbështet dhe lehtëson punën e shkollave dhe mësuesve me nxënësit me aftësi të kufizuara.

Pajisjet ndihmëse, të fituara në formë donacioni, në një masë të madhe përputhen me nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe u mundësojnë atyre të përdorin më lehtë kompjuterin.

Njohuritë dhe aftësitë e fituara me trajnimet mësuesve u ndihmojnë të përdorin më lehtë teknologjinë ndihmëse për nevojat e procesit mësimor.

Pajisjet ndihmëse, të fituara në formë donacioni, janë me cilësi të shkëlqyer.

Teknologjia ndihmëse ndikon pozitivisht në përmirësimin e mundësive arsimore të nxënësve me aftësi të kufizuara. Janë konstatuar efektet pozitive në vazhdim që kanë të bëjnë me përdorimin e teknologjisë së këtij lloji: përmirëson nivelin e përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në procesin mësimor, rrit interesimin e tyre, lehtëson përgatitjen e detyrave shkollore dhe forcon ndjenjën e barazisë dhe vetëbesimin.

Materialet dhe resurset e ofruara janë vegla të dobishme për nxënësit dhe mësuesit.

Ekipet e teknologjisë ndihmëse janë baza e aksesit të sistematizuar drejt përdorimit të teknologjisë ndihmëse për nevojat e procesit mësimor.

Teknologjia ndihmëse kontribuon për përdorimin e metodave të reja të punës me nxënësit me aftësi të kufizuara.

## Rekomandimet

Konkluzionet e prezantuara me këtë hulumtim në formë ankete vërtetojnë nevojën e **implementimit sistematik të teknologjisë ndihmëse në arsim.**

Për realizimin e këtij rekomandimi të përgjithshëm duhen zhvilluar aktivitetet dhe hapat në vazhdim:

1. Të sigurohet një zgjidhje sistematike lidhur me vlerësimin e nevojave për teknologjinë ndihmëse, sigurimin e saj dhe inkuadrimit në të gjitha nivelet e detyrueshme të arsimit.
2. Të prezantohen para institucioneve relevante dhe kreatorëve të politikave efektet e modelit të implementimit dhe përdorimit të teknologjisë ndihmëse në arsim.
3. Të respektohet dhe zbatohet parimi i individualizmit gjatë blerjes dhe sigurimit të teknologjisë kompjuterike për nevojat e shkollave fillore dhe të mesme.
4. Të promovohen para faktorëve relevantë efektet e përdorimit të softuerit edukativ që mundëson qasje në arsim.
5. Të forcohen dhe përmirësohen kapacitetet e shkollave për zbatimin, kontrollimin, evidentimin dhe dokumentimin e efekteve të përdorimit të teknologjisë ndihmëse.

6. Të forcohet bashkëpunimi i shkollave dhe prindërve, lidhur me çështjen e përdorimit të teknologjisë ndihmëse.
7. Të forcohen kapacitetet e shkollave për zbatimin e suksesshëm të politikave arsimore inkluzive.
8. Të forcohet bashkëpunimi midis shkollave fillore dhe të mesme në aspektin e përfshirjes dhe përdorimit të teknologjisë ndihmëse.

## PËRZGJEDHJE TË PRAKTIKAVE TË MIRA NGA MAQEDONIA

### Teknologjia ndihmëse dhe bashkëpunimi i mirë – faktorë sukcesi

M.S, nxënës i klasës së parë, do të shkruajë, vizatojë dhe shikojë filma vizatimorë dhe prezantime edukative. Atij vëmendjen ia tërheqin tingujt dhe me përdorimin e tyre me përmbajtjet mësimore ai mban mend më mirë përmbajtjet mësimore. M.S. është një djalë i urtë dhe i tërhequr në vetvete, i cili si rezultat të dridhjes së duarve nuk mund të mbajë lapsin. Në raste të caktuara ai di të silltet në mënyrë joadekuate, ka përqendrim të dobët dhe probleme me mendimin dhe kujtesën.

Si rezultat të dridhjes së duarve M.S. kursurin mund ta drejtojë më lehtë me trakbol dhe ekranin me taç, ndërsa shkronjat mund t'i shkruajë më lehtë me ndihmën e tastierës së madhe me ngjyra. M.S. përdor butonat e ngadalshëm dhe kursurin që lëviz me një shpejtësi të vogël.

Përqendrim më i mirë; mësim me ndihmën e njohjes; njohuri për termat matematikore elementare; nxitje të orientimit në ambientin dhe kohën dhe realizim individual të aktiviteteve manuale (shkrim, vizatim) janë rezultatet e arritura deri më tani.

### Teknologjia – një mundësi më shumë

B.S. (12) një nxënëse që do të shoqërohet me shokët dhe shoqet, që mund të përshtatet me lehtësi, kureshtare dhe e hapur për njohuri të reja. Detajet, ngjyrat e ndryshme dhe objektet që ndodhen në një largësi më të madhe asaj i shkaktojnë probleme si rezultat të [problemeve me shikimin].



Tastiera e saj me butona të mëdhenj është pasuruar me konture silikon, që ajo të dallojë më lehtë shkronjat dhe numrat. Ajo përdor ekranin me taç, me sfond njëngjyrësh, pa detaje dhe me ikona të mëdha. Me ndihmën e "lexuesit" të ekranit dhe llupën optike B.S. mund të përdor edhe internetin.

Shkrimi dhe leximi më i lehtë dhe mësimi më i lehtë i operacioneve matematikore janë qëllimet e arritura deri më tani me përdorimin e teknologjisë ndihmëse.

## Tani edhe unë shkruaj njësoj si shokët e mi

C.A. nuk ka kompjuter në shtëpi. Para se të fillojë të përdor teknologjinë ndihmëse, ai ka mundur të dallojë vetëm një pjesë të shkronjave të mëdha të shtypit.



Tani C.A. përdor tastierën me butona të mëdhenj, softuerin për fontin dhe ikonat dhe atë të shpejtësisë së lëvizjes së kursorit dhe ekranin me taç.

Teknologjia ndihmëse është përfshirë në planin individual të këtij nxënësi. Ai zgjidh detyrat më lehtë dhe vetë dallon dhe shkruan shkronjat. Suksesin e C.A. e shikojnë edhe shokët e tij të klasës. Teknologjia ndihmëse lehtëson edhe punën e mësueses dhe i mundëson asaj ë përgatis aktivitetet shkollore në një mënyrë kreative.

## Teknologjia ndihmëse një mjet komunikimi

A. është një nxënëse e klasës së dytë. Ajo di të shkruaj fjalë të thjeshta dhe të mbledh numrat deri në dhjetë, por akoma nuk di të flas. Përqendrimin e saj të dobët ajo e drejton dhe mban në aktivitetet e paraqitura me kompjuter.

A. përdor tastierën me butona të mëdhenj dhe ekranin me taç, por përdor edhe laptop-in e shkollës, i cili është me ikona të mëdha dhe shkronja të mëdha. Ekipi i shkollës ka në dispozicion një ambient të veçantë për të punuar vetëm me nxënësen A.

Gjatë prezantimit të përmbajtjeve që nxënësja A ka vështirësi për t'i përvetësuar, përdorimi i softuerit edukativ i ndihmon asaj të mësojë më lehtë. Kompjuteri i shndërrua në një vegël me të cilën mësuesja realizon më lehtë komunikimin dhe kontrollon më mirë përvetësimin e njohurive dhe arritjeve të nxënëses A. Me përdorimin e tastierës me butona të mëdhenj, nxënësja A mësoi të lërë hapësirë midis fjalëve dhe të ndaj fjalët në rrokje.

## PËRZGJEDHJA E PRAKTIKAVE TË MIRA NGA AUSTRIA

### Softuer për akses në arsim

#### Inkluzioni si një e drejtë e njeriut

Inkluzioni kërkon të sigurohet arsimi më i mirë i mundshëm për të gjithë fëmijët dhe garanton se nevojat e çdo fëmije për mbështetje individuale do të plotësohen në masën më të madhe të mundshme.

#### Problemet e nxënësve në shkollat

Problemet psiko-fizike pengojnë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor:

- Problemet fizike pengojnë nxënësit të zgjidhin detyrat me shkrim dhe të mbajnë shënime..
- Problemet në mësimin imponojnë nevojën që përmbajtjet mësimore të përvetësohen gradualisht me ndihmën e njësive të vogla.
- Dëmtimet shqisore imponojnë nevojën që përmbajtjet mësimore të paraqiten në formate dhe medime të ndryshme, ai audio dhe video, me dimensione adekuate, qartësi, ngjyra etj.
- Dëmtimet e të folurit pengojnë nxënësit të japin kontributin e tyre direkt gjatë procesit mësimor nëpërmjet shprehjes verbale.

#### Përparësitë e përdorimit të kompjuterëve në shkollë

Shkolla për arsyet më poshtë është vendi më i mirë për të mësuar përdorimin e kompjuterit:

- Kompjuterët janë një mjet mësimi plotësues,
- Kompjuterët janë vegla protetike,
- Kompjuterët janë vegla për mbështetje të veçantë,
- Kompjuterët mundësojnë të provohen individualiteti dhe efektiviteti,
- Kompjuterët lejojnë gabime,
- Kompjuterët motivojnë dhe mundësojnë argëtim,
- Njohuritë kompjuterike janë një nga teknikat kulturore elementare,
- Ekzistojnë programe të mira arsimore.

#### Zhvillimi i softuerit arsimor

Kriteret e cilësisë së softuerit arsimor janë si më poshtë vijon:

- kohëzgjatja dhe numri i ushtrimeve mund të përshtaten,
- mundësohet asistencë: këshilla dhe ndihmë,
- përmbajtja duhet përshtatur me nevojat e përdoruesve,
- përmbajtja duhet përshtatur me përparimin e përdoruesit,
- fidbeku bazohet në fakte dhe motivon,



- programi mund të përdoret me lehtësi (font i madh, objekte të mëdha, mundësi shfletimi, etj.),
- dalja nga programi është e lehtë,
- është stabil edhe në rastet e përdorimit të gabuar,
- proceset e të mësuarit dokumentohen,
- rezultatet mund të ruhen dhe/ose të printohen,
- prindërit/mësuesit mund të përgatisin sekuencat e tyre për të mësuar me ndihmën e programit dhe
- raporti midis animacioneve dhe sekuencave për mësim duhet balancuar.

### **Koncepti edukativ dhe psikologjik i AboutNumbers**

AboutNumbers (*Rreth numrave*) është një lojë me operacionet matematikore elementare: numërimi, vargjet, numrat dhe operacionet deri në 10. Ky program është paraparë për fëmijët e moshës parashkollore, nxënësit e shkollave fillore, me ose pa aftësi të kufizuara, personat që kanë probleme me matematikën dhe të rinjtë dhe të rriturit që kanë probleme me mësimin.

AboutNumbers bazohet në këndvështrimet e pranuar arsimore dhe pedagogjike:

- Koncept vizual,
- Koncept akustik,
- Opsione të shumta rregullimi,
- Motivacion,
- Aftësi motorike.

AboutNumbers është një program mësimi dhe trajnimi dhe një vegël e dobishme për nevojat e mësimin në klasë.



### **Shembulli më i mirë: Maks Buheger**

#### **Situata fillestare**

Maks është lindur me paralizë cerebrale. Ai nuk mund të përdor duart dhe shakat e tyre për të analizuar ambientin përreth tij dhe për të fituar përvoja. Si një fëmijë ai ishte i fiksuar në karrocë, që të pengohen lëvizjet e tij të pakontrolluara. Prindërvet e tij u mbeti vetëm shpresa se djali i tyre një ditë do të mund të kontrollojë vetë një karrocë elektrike.

Maks ishte këmbëngulës dhe i përkushtuar në aspektin e të folurit. Përpjekjet e tij dhe durimi i prindërvet e tij dhanë rezultatet e pritura. Maksin sot mund ta kuptojnë të gjithë!

#### **Mundësitë e nxënësve me probleme motorike në Austri**

Para regjistrimit në shkollë në Austri fëmijëve me aftësi të kufizuara fillimisht duhet t'u caktohet diagnoza mjekësore. Në rastin e Maksit mjeku konstatoi diagnozën e "aftësive të kufizuara të një forme të rëndë" dhe për të u përgatit një plan arsimit individual. Familja e tij kishte

mundësinë të vendos vetë nëse Maksi do të ndiqte mësimin e rregullt ose një shkollë e veçantë e përshtatur për të plotësuar kushtet e nevojshme. Në fakt, shkollat e veçanta në Austri do të mbyllen deri në vitin 2020.

## Rruga e Maksit

Maks shkoi në kopsht kur filloi të provojë teknologjinë ndihmëse:



Pajisjet ekstra të mëdha që zëvendësuan mausin e kompjuterit ishin opsioni i vetëm.

Maks kaloi trajnime të vështira për të mësuar të kontrollojë pajisjen përkatëse. Atij i duheshin disa muaj për të mësuar plotësisht përdorimin e pajisjes që zëvendësoi mausin e kompjuterit.

Në shkollën e veçantë për fëmijë me probleme fizike, ku ai ndiqte një plan arsimi individual, Maksi mësoi shkronjat dhe numrat. Ai gradualisht mësoi të lexojë dhe shkruaj.

Me ndihmën e softuerit Archimedes Maksi mësoi numrat dhe të numërojë. Programi Multitext përdor të folur të sintetizuar që i mundësoi Maksit të shkruaj, ndërsa shokët e tij të klasës të dëgjojnë komentet e tij.

Përveç softuerëve arsimorë, Maksi përdor edhe internetin dhe e-mailin.

Pas mbarimit të shkollës së detyrueshme, Maksi mbaroi arsimin profesional pa probleme.



## Financimi i teknologjisë ndihmëse në Korushkë

Në Austri akoma nuk është përgatitur një kornizë nacionale për financimin e teknologjive ndihmëse. Provinca të caktuara kanë zgjidhje të veçanta si një lloj përgjigjeje për situatën joadekuatë në nivel nacional. Përgjigjja e shtetit federal Korushka është i ashtuquajtur **resource pool**.

### Historia

Resource pool për herë të parë u planifikua në vitin 1993, *për nevojat e personave me probleme me shikimin*. Me kalimin e viteve pool-i u zgjerua për të siguruar mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore dhe nxënësve me probleme me të folurin.

### Organizimi

Teknologjia ndihmëse kryesisht sigurohet deri në mbarimin e arsimit obligativ. Pajisjet përdoren për intervenim të hershëm në kopshtet inkluzive dhe shkollat fillore, të mesme dhe profesionale inkluzive.

Pajisjet që nuk nevojiten më kthehen në pool. Familjet nuk duhet të paguajnë për pajisjet e këtij lloji. Shpenzimet financohen me mjetet e buxhetit të shtetit.

Pool ka në dispozicion pajisjet në vazhdim:

- pajisje protetike për dëmtimet shqisore,
- pajisje protetike për problemet me të folurin,
- pajisje protetike për problemet fizike dhe mendore,
- pajisje ndihmëse siç janë lexuesit e ekranit, monitorët e Brait, pajisjet për input ose output kompjuterik special etj.,
- softuer i veçantë arsimit,
- pajisje terapeutike/pedagogjike siç janë materialet pedagogjike të adaptuara për problemet motorike, kompletet e veçanta për të luajtur etj.

Në rast se pajisja nuk do të jetë në dispozicion, ajo do të sigurohet me mjete publike.

### Qëllimet e resource pool

Resource pool synon të arrijë qëllimet në vazhdim:

- të sigurojë mbështetje të plotë,
- implementim të shpejtë të teknologjisë ndihmëse,
- përdorim profesional të teknologjisë ndihmëse,
- përdorim ekonomik të teknologjisë ndihmëse,
- menaxhim të përgjegjshëm të resurseve financiare,
- sigurim të teknologjisë ndihmëse të certifikuar nëpërmjet mirëmbajtjes korrente dhe
- vlerësim objektiv i të drejtës së përdorimit të teknologjisë ndihmëse.

## TEKNOLOGJIA NDIHMËSE DHE DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE

### Konventa e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara

Konventa e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara thekson nevojën e teknologjive ndihmëse dhe që mundësojnë akses:

**Neni 4**, ndër të tjera, për vendet që kanë nënshkruar Konventën parasheh si më poshtë:

„(e) Do të zhvillojnë ose promovojnë hulumtime dhe zhvillimin e teknologjive të reja, do të promovohet aksesin dhe përdorimi i tyre, përfshirë teknologjitë e informimit dhe ato të komunikimit, pajisjet ndihmëse për të lëvizur, pajisjet dhe teknologjitë ndihmëse të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara...; dhe

(zh) Do të sigurojnë informata aksesin për personat me aftësi të kufizuara lidhur me pajisjet për të lëvizur, pajisjet dhe teknologjinë ndihmëse, përfshirë teknologjitë e reja...“.

**Neni 9** detyron vendet që kanë nënshkruar Konventën “të promovojnë aksesin tek teknologjitë dhe sistemet e reja të komunikimit për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe internetin “.

**Neni 20** parasheh si më poshtë:

„(b) Lehtësim të aksesit të personave me aftësi të kufizuara tek pajisjet cilësore mobile, teknologjitë ndihmëse, aparatet... me çmime të arsyeshme”; dhe

„(g) Entitetet që prodhojnë pajisjet për lëvizje dhe teknologjitë ndihmëse të inkurajohen të marrin parasysh të gjitha aspektet e personave me aftësi të kufizuara“.

**Neni 21** ndër të tjera parasheh masat në vazhdim:

„(a) Sigurimin e informatave për personat me aftësi të kufizuara, që janë paraparë për opinionin, në formate të përshtatshme dhe teknologji adekuate me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara, në kohën e duhur dhe pa shpenzime plotësuese“ dhe

„(g) Mediat, përfshirë edhe ato që ofrojnë informata me ndihmën e internetit, inkurajohen që tek shërbimet e tyre të mundësojnë akses për personat me aftësi të kufizuara“.

Teknologjia ndihmëse përmendet edhe me **nenin 26**. Vendet që kanë nënshkruar Konventën „... do të promovojnë mundësinë për të përdorur njohuritë dhe përdorimin e teknologjisë dhe pajisjeve ndihmëse, të dizajnuara për nevojat e personave me aftësi të kufizuara...“

### Agjenda digjitale e Strategjisë Evropë 2020 e BE-së

Si një përgjigje e boshllëkut digjital, Bashkimi Evropian përgatiti Agjendën digjitale, si pjesë e Strategjisë Evropë 2020. Qëllimi kryesor i Agjendës digjitale është të mundësojë zhvillimin e një tregu të vetëm digjital në të gjithë Bashkimin Evropian, si një mënyrë për inkurajimin e një zhvillimi të mençur, stabil dhe **inkluziv**.

**Shtylla 6 e Agjendës digjitale – Inkurajimi i edukatës digjitale, aftësive dhe inkluzionit** është orientuar drejt sigurimit të aftësive digjitale për pjesëmarrje të plotë të të gjithë qytetarëve në shoqëri. Me këtë shtyllë interneti është paraparë si kanali kryesor i sigurimit të informatave dhe njohurive, por edhe shërbimeve. Barrierat me të cilat qytetarë të caktuar mund të

ballafaqohen për shkak se nuk mund të përdorin internetin rezultojnë në mënyrë direkte me përjashtimin social.

Për këtë arsye, Agjenda digjitale parasheh masa për sigurimin e aksesit tek teknologjitë moderne për të gjithë dhe sigurimin e aksesit në internet, i cili është gjithnjë e më i rëndësishëm:

- aksioni 63 i referohet Konventës së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe kërkon vlerësimin e aksesit që e mundëson legjislacioni përkatës,
- aksioni 64 parasheh qasje në ueb faqet e sektorit publik në të gjithë BE-në (sipas standardeve ndërkombëtare të ueb aksesit) dhe
- aksioni 67 elaboron përpjekjet për përmirësimin e aksesit tek teknologjitë e informimit dhe komunikimit.

